

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Mirëseerdhët në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak. Ftoj sekretarin të bëj apelin.

Sokol Sinani-Sekretar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Z. Sokol Sinani bën apelin, prezent në sallë janë 41 antarë.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës.

Valbona Balliu – Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Kërkoj informacion mbi sallën e Këshillit Bashkiak ku janë 400 milion lekë?

Asim Sula – Zv. Kryetar i Bashkisë Elbasan

Përsa I përket mobilimit të sallës së Këshillit Bashkiak janë në proces deri në 15 Gusht.

Pika e parë e rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës.

Këshilli Bashkiak me 33 vota pro, - kundër, 2 abstenim, miraton sa më sipër.

(V. Balliu; D. Madhi)

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 2 e rendit të ditës

2. Miratimi I proçesverbalit të muajit Qershor datë 01.07.2025 dhe muajit Korrik date 11.07.2025

Këshilli Bashkiak me 33 vota pro,- kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 3 e rendit të ditës

3. Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I Bashkisë për Muajin Qershor 2025

Këshilli Bashkiak me 37 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 3.1 e rendit të ditës

3.1 Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar për Muajin Qershor 2025

Këshilli Bashkiak me 37 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

(A.Shtylla;E.Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 4 e rendit të ditës

4. Informacion për Këshillin Bashkiak Elbasan -Hartimi I Planit Social Vendor 2025-2028 Bashkia Elbasan

Eltiona Kolla-Përfaqësues I Administratës

Aktualisht është dhënë vetëm si informacion. Do të shikojmë disa pika kyçe për këtë plan. Kush të dëshirojë mund të bashkëngjitet grupit të punës për të hartuar këtë plan.

Valbona Balliu-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Ne po kapim standartet e BE, është ulur varfëria dhe nga ana tjetër ne na del e zgjeruar harta në qytetin e Elbasanit. Ktu ka një mospërputhje. Këtë politikën ju e përputhni me polikat shtetërore apo dalim thjesht të shtojmë familje me ndihmë ekonomike dhe të shtojmë fonde nga taksapaguesit. Çfarë masash ka marrë drejtorja juaj për ta përmirsuar dhe për ta ngushtuar hartën e shtresës së varfërisë? Sa jeni përpjekur ju të ofroni punësim për gratë, për fëmijët mbi moshën 18 vjeç? Sa jeni përpjekur ju të hapni mikrobiznese për ta ndihmuar pikërisht këtë shtresë sepse nuk është i mjaftueshëm vetëm ai 18.000 lekshi vjetër apo 34.000 lekshi që merr nga Bashkia? Kush është përpjekja juaj pasi Zoti Kryeministër thotë ne kemi rritur standartin e jetesës, ndërsa ju në Këshill Bashkiak na parashtroni ne që kjo hartë duhet riparë, duhet zgjeruar, duhet përmirsuar sepse ne na janë shtuar familjet në nevojë. Ka një mospërputhje skandaloze mes propagandës shtetërore që na paraqitet ne nga Zoti Kryeministër dhe nga kërkesa që bën Bashkia juaj. Prandaj ju lutem kur hartoni kto plane duhet të jeni në kordinatë të plotë me politikat shtetërore.

Eltiona Kolla-Përfaqesuese e Administratës

E nderuar Zonja Valbona pyetja juaj sigurisht është me vlerë për të gjithë ne. Patjetër që ne bazohemi në strategji dhe nuk ecim vetëm mbi planet e pushtetit vendor. Mbi të gjitha ne duhet të zbatojmë një ligj por jau cilësova që në fillim, Bashkia është drejt hartëzimit të shërbimeve sociale, duke identifikuar nevojat dhe bazuar në nevoja ne duhet të ofrojmë shërbime sa më cilësore. Për këtë arsye ne po e rishikojmë edhe njëherë planin për të ofruar shërbime sa më cilësore. Prandaj bëjmë dhe një thirrje të hapur që ju ti bashkoheni grupit dhe gjithsecili nga ju të japi mendimin e tij në mënyrë që të bashkëpunojmë sepse në fund të fundit jemi qytetarë të këtij qyteti, mendojmë për qytetin dhe njerëzit e tij.

Doris Madhi-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Unë mendoj që në këtë pikë duhen lënë mënjane sentimentalizmat që jemi qytetarë të këtij qyteti sepse e kemi parë sa e duan këtë qytet kta që po e qeverisin. Përpos kësaj, puna është që Zonja Valbona ju bëri një pyetje shumë specifike: A keni ju një studim real, me shifra, me të dhëna në të cilën do të zbatoni hartimin e këtij plani të ri në të cilin na kërkon dhe ne të marrim pjesë? Ka studim real në shifra? Po ose jo? Po, e keni këtë. Pse nuk e sillni të bashkangjitur këtë bashkë me shkresën e relacionit në mënyrë të tillë që dhe ne të bindemi në mënyrë të bazuar se kto shifra kanë nevojë për një studim të ri? Dhe nuk jeni duke futur në hartë dhe duke shpërblyer ato fakirët që deri tani u dogjën me tymin e inceneratorit, ky është fakt. Ne jemi Këshilltarë Bashkiak dhe akses në ëeb kanë të gjithë. Neve ktu n'akeni sjellë dokumenta të firmosura.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kjo pikë nuk ka nevojë për votim, ishte informacion. Kalojmë tek pika 5

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 5 e rendit të ditës

5.Mbi miratimin në parim të dokumentit strategjik :”Plani vendor I veprimit për barazinë gjinore 2025-2030”

Asim Sula-NënKryetar I Bashkisë Elbasan

Përsa I përket planit vendor të barazisë gjinore 2025-2030 është një plan I hartuar me shumë kujdes dhe profesionalizëm sigurisht dhe me ndihmën e dy ekspertëve dhe me mbështetjen e grupit të punës. Bëhet fjalë për një plan përsa I përket barazisë gjinore dhe si kryetar I grupit do shpjegoj hartimin e këtij plani dhe jo vetëm këtë plan sepse ne kemi kaluar dhe shumë plane të tjera të ndryshme të cilat janë plane orientuese. Në këtë rast bëhet fjalë për një plan ku konsiston në tre komponente të rëndësishme: 1-Fuqizimi ekonomik I gruas. 2-Në përfshirjen e qeverisjes vendore të gruas. 3-Plani I dhunës së barazisë gjinore. Janë tre komponente të rëndësishme por ajo që u fokusuar është fuqizimi ekonomik I gruas që do të thotë mund të përjashtohen gratë nga taksat vendore

Valbona Balliu-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Zoti Asim a keni patur një plan lidhur me barazinë gjinore?

Asim Sula-NënKryetar I Bashkisë Elbasan

Sigurisht, ka qenë plani 2025-2028 dhe plani I ri është 2025-2030

Valbona Balliu-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

A I keni arritur objektivat e planit 2025 ju? Keni një pasqyrë ku të shkruhet çfarë duhet përmirësuar dhe çfarë nuk duhet përmirësuar?

Asim Sula-NënKryetar I Bashkisë Elbasan

Ktë ju do ta shikoni te rendi I ditës.

Valbona Balliu-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

E pashë te rendi I ditës,material ishte thjesht propogandistik.Sa gra kanë përfituar nga plani që është sot?Akoma duhet kërkuar leje për të hartuar planin.

Valbona Balliu-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Materiali ju ka ardhur në email, mund ta lexoni.

Asim Sula-NënKryetar I Bashkisë Elbasan

Atëherë po ju shtojmë,ju lutem dëgjoni.Do keni në rendin e ditës dhe planin e monitorimit dhe raporti I planit të monitorimit të barazisë gjinore.Raporti I monitorimit do të thotë që ky raport për periudhën e kaluar është monitorua. Janë nxjerrë disa tregues dhe këta tregues janë shumë të rëndësishëm dhe ne i kemi zbatuar në planin e barazisë gjinore 2025-2030.Pra të bësh një raport dhe të nxjerrësh të metat e planit të mëparshëm, kjo është shumë e rëndësishme.Raportet e monitorimit janë dokumenta të rëndësishme që ndihmojnë në zbatimin e planit urban.Ky është një plan I kostuar sidomos me buxhetin e Bashkisë.Pra, jo vetëm një plan I bërë mirë profesionalisht por edhe një plan I kostuar.

Valbona Balliu-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Koha që kalojë Këshillin si mbledhje partie.Nuk po ofendoj askënd.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Po vazhdoje të flasësh pa leje do të tërheq vëmendjen dhe do dalësh jashtë.Fjala për Zotin Muzhaqi.

Ergys Muzhaqi – Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Përsa I përket planit që keni bërë ju përgëzoj.Nga ana juridike nuk jam I interesuar për planet e barazisë gjinore, më pëlqejnë më shumë zakonet dhe traditat.Megjithatë nuk gjykoj problematikë këtu.Ne kemi 2 pika shumë të rëndësishme për të diskutuar, 2 interpelanca që na prekin të gjithëve dhe I lutem këshilltarëve ti kalojmë shpejt këto pika që të vazhdojmë me interpelancat.

Këshilli Bashkiak me 32 vota pro, - kundër, 6- abstenim, miraton sa më sipër.

(D.Madhi;V.Balliu;A.Kana;E.Muzhaqi;M.Kaçuli,A.Shtylla)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 6 e rendit të ditës

6.Mbi miratimin e raportit të Monitorimit të Planit vendor të veprimit për barazinë gjinore 2022-2024

Këshilli Bashkiak me 32 vota pro, - kundër, 6 abstënim, miraton sa më sipër.

(D.Madhi; V.Balliu; A.Kana; E.Muzhaqi; M.Kaçuli, A.Shtylla)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 7 e rendit të ditës

7.Transformimin e “Klubit Sportiv Elbasani” në organizatë jofitimprurëse dhe miratimin e akteve të thellimit të saj

Mirand Backa-Përfaqesues I Administratës

Është një procedurë që duhej të bëhej më herët. Është një politikë që ndiqet dhe nga federate Shqiptare. Nuk është Shoqatë tipike autonome siç mund të dalin një grup njerëzish dhe e bën këtë. Do suportohemi pak nga Bashkia në vendimin e Këshillit Bashkiak.

Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak

Në relacionin që kam në dorë, ajo që arrij të kuptoj unë që ky klub I cili është në varësi të bashkisë Elbasan, në të gjitha aspektet sidomos në ato financiare, do të shndërrohet në një OJF. Një OJF ka disa përcaktime dhe limite ligjore përse I përket edhe trajtimit të buxhetit, edhe trajtimit të punonjësve, edhe menyrës se si do të financohen. Kështu që përgjigje në dritë e cila për mua është pak evazive, duket sikur fati I ktyre punonjësve do jetë në dorë dhe në dashamirsinë e Bashkisë Elbasan. Jo se na jepet një përgjigje e saktë, se cili do të jetë realisht fati I tyre duke qenë se do të transformohet shoqëria që do marri formën e një OJF-je. Nëse Bashkia vazhdon Akoma qëndron në thonjëza pronare e kësaj shoqërie atëherë do të thotë që kjo shoqëri do të ketë të drejtën e aksesit të fondeve apo të gjitha llojeve të projekteve që mund të shpalli edhe Bashkimi European në lidhje me kto lloj sportesh. Pastaj kto fonde do vijnë në Bashki apo do I shkojnë kësaj OJF-së? Na e ndani pak se si do të jetë forma e pronësisë se si OJF është OJF nuk ka më pronarë. Ajo që do të doja unë sot të shikoja në relacion është një gjendje aktuale e

financave të klubit shumësportësh dhe një gjendje aktuale e punonjësve të klubit dhe ajo që supozohet të arrini juve duke e shndërruar në një OJF. Kështu bëhet shndërrimi edhe ligjor sepse ka shumë juristë këtu dhe e kuptojnë shumë mirë çfarë jam duke thënë. Nuk bëhet shndërrimi ligjor me sentimentalizma dhe me relacione të këtij lloji, jemi sportdashës nuk jemi sportdashës... Ka ca pika ktu që nuk na sqarojnë asgjë. Dua një relacion të gjendjes aktuale financiare të klubit. Dhe ku do shkojë pastaj kjo gjendja, si do ndahet? Duhet një relacion tjetër në lidhje me punonjësit e këtij klubi. Ne kemi bërë transformime të tilla, bëmë edhe vjet për sportklubin e Elbasanit dhe e bëmë në të njëjtën formë, me idenë se ishte markatoja në Shtator, e liruam neve të opozitës dorën që mos ti prishnim punë sportklubit. Edhe sot e kësaj dite nuk e morëm vesh sa ishte humbja dhe sa ishte fitimi transformimit përveç se kur dolëm nëpër Gazeta dhe mallkuam veten pse e miratuam. Prapë në gazetë do dalim?

Valbona Balliu-Anëtrae e Këshillit Bashkiak

Atëherë pyetja tjetër që unë do ti drejtoja Zotit Mirand. Bëhet fjalë për asetet sportive. Të gjitha terrenet sportive që sot janë pjesë e Bashkisë Elbasan sepse janë ndërtuar më djersën dhe mundin e taksave të qytetarëve ndër vite, do ti kalojnë kësaj OJF-së? Apo do të mbeten sërish në pronësi të Bashkisë dhe do ti merrni qera kësaj ose do ja jepni dhe fala? Unë dua të di terrenet sportive

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Të gjitha infrastrukturat sportive janë pjesë e bashkisë dhe nuk të transferon infrastrukturë sportive, as pallat sporti, as terrene sportive. E njëjta mënyrë funksionimi që ne sot si Bashki ja kemi dhënë në administrim klubit shumësportësh dhe ato kanë të drejtë të përdorin për efekte trajnimit ashtu siç ke palestën te Shkolla Vasil Kamami që përdoret nga pingpongu, siç përdoret pallati I sportit nga klubi basketbollit etj e njëjta gjë ndodh edhe tani. Është thjeshtë ndryshimi I formës ligjore. Ka një ndryshim të formës ligjore të funksionimit, pra nuk ke transferim, pronë e Bashkisë janë dhe pronë e Bashkisë do jenë. Në rast se do ti duhet klubit shumësportësh ta përdori për efektet të veta sportive për të arritë qëllimin sepse ne se kemi palestrën e shkollës për ti mbajtur të mbyllura, janë për efekt sporti, për tu trajnuar të rinjtë dhe e ke të shënuar aty nëse e ke lexuar materialin se aty ta thotë. Nuk ka ndryshim pronësie. Nuk po I transferohet absolutisht asnjë aset I Bashkisë OJF-së. OJF-ja nuk asete. Ato janë pronë e

Bashkisë dhe transferimi I pronave të Bashkisë, ju e dini shumë mirë ka një roçedurë tjetër ligjore.Ktu ke një akt themelimi, ke një mënyrë si do organizohet klubi shumësportësh,mënyra si do organizohet vet,mënyra që kanë punonjësit që do merren aty,kaq është.

Valbona Balliu-Anëtare e Këshillit Bashkiak

Ka dështuar Bashkia për këtë rast?

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Ktë dëshirën tuaj që vetëm dështimin ne...që vetëm ju e bëni të dështuar, ka një detyrim ligjor.Mbasi janë mbyllur aktet rregullatore të Këshillit Të Ministrave,ka një formë tjetër të menaxhimit të klubit shumësportësh.Edhe për kalimin e parave tona se me paratë tona do funksionojë prapë,ne do I japim dieta sportistëve,ne do I mbajmë,e njëjta gjë është.Është thjesht ndryshimi I formës ligjore.Klubi shumësportësh I sotshmi ka arritur nivelet më të larta.Organizatrat që kemi ne ktu kanë federatën e vet dhe kto automatikisht njohin ose organizatën jofitimprurëse ose klubin që ka ngelur si traditë.Tani po ndryshohet forma ligjore e ktij, kaq është.Kontrolli është prapë I Bashkisë, të ardhurat do vijnë prapë nga Bashkia.I jepet mundësi që kjo organizatë të krijojë të ardhura të tjera shtesë që është një gjë shumë e drejtë, shumë llogjike.Nuk ka qen asnjëherë Sh.A, ka qen institucion I Bashkisë.Ka një formë të kontrollit të tyre, patjetër që ne do I kalojmë nga Bashkia, do I kontrollojmë edhe nga Bashkia.

Këshilli Bashkiak me 31 vota pro, - kundër, 5 abstenim, miraton sa më sipër.

(D.Madhi;V.Balliu;A.Kana;E.Muzhaqi;A.Shtylla)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 8 e rendit të ditës

8.Mbi transferimin e aseteve të dy institucioneve ish Agjensia e Kulturës dhe turizmit si dhe ish Qendra e Artit tek Drejtoria e Kulturës dhe Sporteve si dhe Drejtoria e Politikave të Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore, Bashkia Elbasan.

Erki Koka-Përfaqësues I Administratës

Është bërë ristrukturimi I Institucioneve vartëse të Bashkisë dhe Agjensia Kulturës dhe Turizmit dhe Qendra e Artit janë bashkuar drejtorisë së përgjithshme. Ky Bashkim sjell bashkimin e aseteve që kanë patur të dyja institucionet. Me mbylljen e këtyre institucioneve dhe në bazë të gjërave që kanë patur në ngarkim I transferohen drejtorisë së përgjithshme.

Këshilli Bashkiak me 30 vota pro, - kundër, 3 abstënim, miraton sa më sipër.

(E.Muzhaqi;R.Mita;A.Shtylla)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 9 e rendit të ditës

9.Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit me interes publik “Sistemim dhe asfaltim I rrugës “Qamil Lopari” ndodhur në Z.K 8523 dhe Z.K 2124”, nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi.

Arba Suli-Përfaqësuese e Administratës

Kemi të bëjmë me 3 procedura shpronësimi, si fillim janë 2 rrugë, është rruga Bajram Curri dhe rruga Qamil Lopari. Për të dyja këto rrugë bashkangjitur materialit keni edhe projektin për të qenë më të saktë në lidhje me detajet. Është miratim në parim, çka do të thotë që përse I përket çmimit apo konfirmimit të pronarëve procedura vazhdon pas konfirmimit të të dhënave nga hipoteka, më pas vazhdoet me dosjen e shpronësimit. Do të ndaloja pak tek procedura e 3 që është procedura e shpronësimit në lidhje me Teatrin Skampa. Teatrin Skampa e kemi në bashkëpronësi, jo thjesht në pronësi dhe bashkëpronësia është fituar nëpërmjet aktit të kthimit të kompesimit të pronave të vitit 1992. Janë 5 familje të cilët rezultojnë bashkëpronarë. Për këto 5 familje Bashkia ka nisur procedurat për njoftimin për secalin prej tyre, ka bërë regjistrimin. Bashkëlidhur keni edhe materialin se kush janë familjet. Normalisht do të nënshtrohemi procedurave të shpronësimit. Sigurisht të dhënat në lidhje me teatrin do të merren të konfirmuara nga ASHP-ja, qoftë për çmimin, qoftë për konfirmimin përfundimtar të pronarëve. Është dhe një material tjetër, ka të bëjë me transferimin e një prone për kalimin në pronësi të një rruge në Njësinë Gracen. Është një rrugë e cila Bashkia Gracen do të investojë në këtë rrugë meqenëse ishte rrugë shtet por nuk ishte në inventaret e Bashkisë. I është kërkuar

Ministrisë së Ekonomisë dakortësimi në lidhje me kryerjen e investimit kemi marrë dakortësimin për kalimin në pronësi të kësaj rruge dhe kërkohet miratimi i Këshillit Bashkiak, në mënyrë që të vazhdojmë me miratimin me VKM.

Zamir Muzhaqi – Nënkyetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Në komision morëm informacion, të 4 pikat janë në parim. Jemi dakort në parim që ti kalojmë si pika. Do ju lutesha që të bëhen publikë emrat e familjarëve të 5 familjeve që janë bashkëpronarë sepse nga informacioni që morëm nuk është se është paraqitur ndonjë nga këto familjarë.

Arba Suli-Përfaqësuese e Administratës

Dua të shpjegoj diçka. Që në momentin që është konstatuar dhe është marrë dokumenti tekniko-ligjor, është vërtetuar që këto 5 familje janë bashkëpronarët. Është bërë njoftimi jo vetëm për shpronësimin por është bërë njoftimi që për secilin prej këtyre familjeve apo trashëgimtarët e tyre, të paraqiten pranë Bashkisë Elbasan për të paraqitur dokumentacionin që ata disponojnë. Njoftimi vazhdon të jetë i publikueshëm dhe pas miratimit në parim nga ana juaj do të bëhet një njoftim i dytë në lidhje me këto familje. Është bërë edhe një njoftim individual për familjet, jo vetëm në media apo në faqet zyrtare të Bashkisë, por me thën të drejtën nuk e di a ka shkuar në familjet përkatëse apo jo sepse janë emra të stërgjyshërve.

Zamir Muzhaqi – Nënkyetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

A ka plan rikonstruksioni teatri?

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Sot është një hap i rëndësishëm i cili është një mirkuptim i gjatë që është bërë mes dokumentacionesh, shkresash të Bashkisë Elbasanit, për zgjidhjen përfundimtare të pronësisë së teatrit. Është një vendim shumë i vjetër, ne sot na detyron të gjithëve për shkak të një vendimi gjykatë në lidhje me një pjesë të hollit të Teatrit Skampa ta lëmë të ish-pronarët. Është një vendim i Këshillit Bashkiak të cilin.. në fakt unë do të kërkoja që mbas hapave të para që është miratimi i këtij vendimi, në mbledhjet e rradhës të Këshillit Bashkiak të shohim mundësinë edhe të anulimit të atij vendimi dhe kompesimit përkatës. Drejtoria juridike ka punuar gjatë për këtë çështje bashkë me drejtorin e pronave. Tashmë e gjithë pasqyra është e qartë, të gjitha

problematikave që kemi patur me teatrin Skampa dhe me funksionimin e tij si pronë e vetme. Kemi përfunduar projektin për teatrin Skampa. Janë 2 projekte ku I pari nuk ka marrë miratimin nga Ministria e Kulturës, ka patur një kërkesë për ndryshime të vogla. Kemi dhe projektin tjetër të përshtatur, të rregulluar pra kemi një projekt të detajuar. Hapi tjetër që është për financimin e tij është në fillim shpronësimi, këtë kemi gjykuar dhe për këtë po marrim miratimin tuaj si Këshill Bashkiak. Të gjitha investimet kapin një vlerë prej 1.4 milion euro për rikonstruksionin e teatrit, dhe kjo duhet ti rriste në mënyrë të drejtpërdrejtë vlerën pronës me këtë fakt do të rriste dhe vlerën takuese të bashkëpronarëve që janë. Kështu që për sa kohë janë fonde të Shtetit Shqiptar të cilat do investohen, dhe jo të bashkëpronarëve, ne kërkojmë si qëllim të bëhet akti i shpronësimit. Proçedurat ligjore siç i shpjegoi dhe drejtoresha, drejtoria e pronave I ka marrë, janë bërë dhe njoftimet dhe shpalljet publike për të gjithë trashëgimtarët që të paraqiten e të plotësojnë dokumentacionin përkatës. Teatri ruan të njëjtë strukturë që ka, i rikonstruktuar me të njëjtat modalitete, tipologji të kërkuara nga Ministria e Kulturës. Edhe për ruajtjen e fasadës së jashtme, në formën që ka vet, me pedenat e kalasë pramodeli jashtëm rri po i njëjtë. Salla e brendshme ka ndërhyrje sepse do të vensosen sisteme ngrohje, ftohje. Edhe tek teatri i kukullave të cilin e rihapëm në katin e dytë për fëmijët, edhe aty do ketë rikonstruksion total. Ne kemi bërë deri tani konstruksione të pjesshme ku më shumë janë rimbajtje siç kanë qenë dhomat e aktorëve apo tualetet e teatrit.

Këshilli Bashkiak me 32 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar i Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 10 e rendit të ditës

10.Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit me interes publik “Sistemim dhe asfaltim I rrugës “Bajram Curri”, nga intersektimi me rrugën “Vasil Llapushi” deri në intersektimin me rrugë “Iliaz Kosova”ndodhur në Z.K 8523, nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi.

Këshilli Bashkiak me 33 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 11 e rendit të ditës

11.Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronsimin e pjesëve takuese të pronarëve privat me pasuri nr.1/12 ndodhur në Z.K 8521, për realizimin e projektit me interes publik “Rikonstruksion I plotë I objektit “Teatri Skampa” në lagjen “Luigj Gurakuqi” Z.K 8521, nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi.

Këshilli Bashkiak me 32 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 12 e rendit të ditës

12.Mbi miratimin e fillimit të procedurave për kalimin në pronësi të pasurisë nr.269 të llojit “rrugë” ndodhur në Z.K 3346,Njësia Administrative Gracen dhe regjistrimin e saj në emër të Bashkisë Elbasan

Këshilli Bashkiak me 33 vota pro, - kundër, - abstënim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 13 e rendit të ditës

13. Për miratimin e kryerjes së studimit të potencialit të erërave, me synim ndërtimin e parqeve eolike në Bashkinë e Elbasanit (Zona e Krrabës)

Përfaqësuesi Administratës

Ky material konsiston në vendosjen e 3 kullave provizore në zonën e Krrabës që do të jenë për studime inxhinerike me qëllim matjen e potencialit të erërave të Krrabës. Impakti ktyre kullave do të jetë pothuajse zero pasi do të vendosim të kapura mbi gonxha anësore dhe do të jeta kundrejt tarifave përkatëse të përcaktuara nga aktet ligjore të miratuara për sektorin e pyjeve. Kto do të vendosen në pronë publike. Do të jetë diçka positive për Bashkinë Elbasan pasi do të kenë një informacion të detajuar për zhvelimin e ktij aktiviteti të parqeve eolike. Janë 2 subjekte që kanë bërë kërkesë pranë Bashkisë Elbasan. Afati I ktyre do të jetë 2 vjeçar, është thjesht për çështje studimi

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Është një studim që nuk do paguajmë para për këtë. Janë kompani, studio, institucione që janë të interesuara të kenë të dhëna për potencialet eolike të erës që ka Elbasani, dhe ato energjitike. Ky është një rast I tillë ku në mënyrë provizore bëhet matja e potencialit të erës, është thjesht për studim.

Ergys Muzhaqi-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Për mendimin tim është një iniciativë shumë e mirë, është goxha e vonuar sepse duhet të ishte studju.E deklaroj votën time pro që të bëhet ky studim dhe ishalla na del për hajër.

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 14 e rendit të ditës

14. Për miratimin e kryerjes së studimit të potencialit të erërave, me synim ndërtimin e parqeve eolike në Bashkinë e Elbasanit (Zona Fushë-Buall)

Këshilli Bashkiak me 33 vota pro, - kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

(V. Balliu)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 15 e rendit të ditës

15. Për përdorimin e fondit pyjor dhe miratimin në parim me qëllim vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor publik të sipërfaqes që do të përdoret për implementimin e projektit “Zip Line në Liqenin e Funarit”, Bashkia Elbasan

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Kemi potencial për turizmin ashtu siç kemi për energjinë të cilën duam ta shfrytëzojmë në Bashkinë e Elbasanit. Përveç Gjinarit ka marrë një dimension tjetër edhe Funari, I cili po destinohet për sportet e natyrës. Kemi fituar para disa vitesh projektin e parë nga Maqedonia e Veriut dhe tani kemi fituar përsëri. Jemi shpallur fitues të projektit të dytë me Bashkinë e Krushevës nga Maqedonia e Veriut për Funarin për zhvillimin e sporteve. Kemi një projekt për të bërë një Zip line në Funar. Është një sport I cili është I lidhur me kavo, nuk prek natyrën thjesht rrëshqet. Është një aktivitet që tërheq shumë të rinj. Do vendoset kulla e parë në njërin nga kodrat, kërkohet që të hiqet nga fondi pyjor në mënyrë që ti lihet njësisë të ndërtohet kulla e cila do të vendoset për të kapur linjën e Zip line-it. Ktë e bën fondi Shqiptar dhe I mbetet bashkisë Elbasan. Në Funarë ne kemi një qendër informacioni, kemi një person të punësuar, kemi një shërbim të cilin e ofrojmë, kemi biçikleta të cilat jepen më qera ku ju I keni miratuar edhe tarifën. Kemi edhe kanoe ku dhe ato për sporte të ndryshme jepen me qera. Kemi patur bashkëpunim edhe me banorët e zonës për ofrimin e guidave të ndryshme me të huajt. Kjo është një ekonomi plus për banorët e zonës të cilës e kanë këtë mundësi të ofrojnë guidë. Ktu nuk kemi miratimin e projektit, është thjesht për heqjen nga fondi pyjor.

Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Ju përgëzoj për iniciativën dhe për promovimin që I bëni turizmit në Elbasan por ajo çka dua të evidentoj është rruga. Duke u shtuar ofertat turistike në zonën e Funarit atëhere shtohet dhe interesi I qytetarëve. Po ua ve në dukje sepse të gjithë kemi shkuar në Funarë dhe rruga është jo në nivelin që kërkohet për mundësinë turistike që ju mendoni ta zhvilloni. Ajo rrugë e cila është e pakonstruktuar është e pamjaftueshme, e ngushtë dhe e rrezikshme, pa barriera mbrojtëse dhe ju sugjeroj që në të ardhmen të miratohet një fond I mjaftueshëm, një plan I cili është I denjë, rrugë të denja për destinacionin turistik. Jua ve në dukje sepse unë e bëj shpesh atë rrugë, jo thjesht me makinë por edhe me biçikletë dhe është shumë e rrezikshme. Mos na kthehet nesër në një njollë të zezë për incidente.

Këshilli Bashkiak me 38 vota pro, - kundër, abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 16 e rendit të ditës

16. Për përditësimin e tarifave të transportit rrethqytetës

Dashamir Celibashi-Përfaqësues I Administratës

Nga sektori I transportit unë kam një propozim për rishikimin e tarifave të transportit. Tarifat janë rishikuar në vitin 2017, lind nevoja që të rishikohen. Kto rritje bëhen me qëllim që shpenzimet e operatorëve dhe shpenzimet e qytetarëve të barazohen duke patur një balancë në rritjen e tyre. Ky ishte propozimi I parë. Propozimi I dytë ka të bëjë me rishikimin e tarifave të taksive. Ka qenë një kërkesë e hershme e taksive, që nga viti 2008 nuk janë rishikuar dhe kemi propozuar tarifën e dyta të rishikuar. Kemi rënë dakort me shoqatën e taksive dhe është dakortësuar që kjo tarifa të miratohet. Kërkojmë nga Këshilli Bashkiak të miratohet kjo tarifa.

Shfaqet Bullari -Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Të dyja kjo tarifa janë miratuar që në vitin 2017 dhe ka një periudhë 8 vjeçare që nuk ka pësuar asnjë rritje megjithëse është rritur kosto e karburantit, e mirmbajtjes mjeteve, shpenzimet e mirmbajtjes, pages minimale etj. Të gjitha këto ne na diktajn që ne të rishikojmë edhe njëherë këto tarifa që të garantojmë operatorët të vijojnë gadishmërinë dhe cilësinë e shërbimit. Në fakt ne kemi sot tarifa që nuk përputhen me tarifën e vitit 2017 sepse janë shumë të vjetra dhe duhet ndryshuar edhe më shpejt. E për shërbimin taksit është e njëjta metodë dhe kemi gjoherë rritje të kostove të këtyre operatorëve të cilët kërkojnë që me kërkesë të kësaj shoqate të rishikojmë tarifën që të garantojmë shërbimin sa më cilësor ndaj qytetarëve. Duhet miratuar madje jemi të vonuar.

Doris Madhi -Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Përsa I përket rritjes së tarifave të shërbimit taksi, duke qenë se shërbimi taksi është një shërbim alternativ I transportit urban apo ndërrurban të mundësuar nga Bashkia Elbasan, nuk dua të diskutoj përveç se të bëj një parantezë të faktit se sa herë që vij në Këshillin Bashkiak për të kërkuar ndryshim tarifash vihet me një analizë të saktë të kostos.Pra juve e keni shënuar që ka 21% inflacion të akumuluar pastaj të tjerat ja vendosni kosto të tjera dhe e çoni në 40% rritjen e tarifës, ndërkohë që nuk na thoni sa janë këto kostot e tjera të tarritura dhe nuk na thoni rritje ekonomike ka patur Elbasani që të mund ta përballojë këtë?Pak më përpara na miratuan një pikë që na ishte rritur varfëria dhe po shtonim hartën e atyre që do subvencionohen ndërkohë tani rritni me 40-50% tarifat e lëvizjes.Kush është politika e rritjes së Bashkisë Elbasan, a ka rritje ekonomike Elbasani apo jo?A e përballojnë qytetarët rritjen 40%?A qëndron kjo rritje brenda marzheve normale të fitimit të taksive që duhet të jetë 10-15% në një situatë normale rritje ekonomike?Analizat nuk bëhen as me fjalë as me pretendime por bëhen me Shifra dhe për aq kohë sa ka 2-3 veta ktej vërdallë që shifrat din ti lexojnë dhe interpretojnë, ju nuk mund të vini me një relacion të tillë.Përsa I përket transportit ndërqytetas më bën të njëjtën përshtypje, ka një rritje fikse nga 40-50% të tarifave.Nga 2017 në 2025 që jemi sot kostoja kryesore që është ajo e naftës ka ndryshuar shumë herë.Në vitet 2021-2022 në kohë pandemike shifrat kan qen shumë herë më të larta dhe në njëfarë mënyre kto shërbime kanë mbijetuar.Pse sot nuk mbijetokan dot?Edhe rritja qenka fikse 40%?Edhe ktu duhet detajimi Kostos.A e keni bërë ndonjëherë llogarinë të të ardhurave mesatare të një fshatari dhe sa mund ta përballojë këtë rritje tarife apo jo?Hajde se taksive po themi që janë ato që e pëlqejnë luksin, po të kti shërbimi që duhet ta ken se sbën?Analiza e Kostos ve përballë 2 komponentë:kostot dhe të ardhurat.Unë ktu të ardhura nuk shoh, shikoj vetëm koston e infacionit që është 20% dhe më lind e drejta të them që rritja duhet të jetë vetëm 20%.

Hektor Çiftja-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ky problemi taksive nuk është nga problemet themelore, por mosvendosja e çmimit të taksive ka formular një informalitet të taksitë. Ato çmimin e taksive e kanë si e duan vetë, si e ka tregu dhe ne nuk i mbledhim dot asnjë lloj detyrimi atyre për shkak se taksimetri atyre figuron me çmimet e vjetra. Pra ky vendim shmang informalitetin dhe me shpresë grumbullon të ardhurat. Tek fshatarët kemi bërë autobusin interurban që vjen nga nga fshati në qytet. Pra për historinë e taksisë unë mendoj që ka informalitet mirëpo informaliteti është që Bashkia nuk i mbledh dot në taksimet të ardhurat pasi shifrat janë shumë të vjetra ndërkohë që ato po operojnë me Shifra bashkëkohore.

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Kjo ka qenë një kërkesë e hershme. Ka patur një kërkesë të vazhdueshme nga kompanitë e transportit për indeksimin e çmimit. Nuk po bëjmë asnjë rritje abuzive, asnjë rritje të paqëndrueshme. Ka qenë koha e pandemisë ku janë vendosur ato çmime që janë sot. Pas pandemisë është indeksuar edhe vlera e transportit urban të qytetit. Shoqatat e transportit kanë qenë insistuese tek indeksimi i çmimit i cili nuk është bërë. Është bërë një formulë, ka patur në fakt edhe të vendimi i vjetër në gjykimin e specialistëve të transportit, pa saktësi pra vendosje të kilometrave, pasi me llogjikë është vendosja e kilometrave e cila vendos edhe tarifën për fshatra të caktuar. Janë marrë parasysh zonat malore, fushore të studimi që kanë bërë inxhinierët për komponentët në vendosjen e tarifave për indeksimin e tyre dhe kanë dalë në këtë rezultat i cili ka lidhje vetëm me indeksimin, përshtatjen e çmimit të biletës me koston. Sistemi i transportit në Elbasan funksionon me licenca 10 vjeçare dhe në vitin 2027 këto licenca përfundojnë, një pjesë e madhe e tyre. Jemi duke bërë një studim bashkë me ndihmën e ekspertëve të huaj për të ridimensionuar sistemin tonë të transportit publik deri në 2027. Po shohim të kemi mundësinë e linjave të transportit bashkiak. Ka problematika patjetër. Jemi duke diskutuar për vendosjen e disa autobusave me bateri për linnja të ndryshme specifike. Do implementojmë së shpejti një projekt për autobuzat urban dhe për vendosjen e një modeli të ri të stacioneve, një modeli smart të stacioneve. Kemi paisur të gjithë linjën urbane të qytetit, jo linjën ndërrurbane vetëm qytetin, me një sistem të ri gps që në kohë reale do të bëjnë të mundur jo vetëm monitorimin por edhe kohën e përcaktuar saktë të autobuzit se kur ikën. Ndërkohë po punohet për të patur një

system më të apdeituar të hartës të urbanit dhe patjetër kërkohet që edhe tarifat e ndërqyteteve sidomos të Njësi Administrative, këtë shërbim urban që ne kemi të mos e çojmë drejt falimentit për tu bër pengesë për indeksimin e tarifave që ato kanë të biletës. Jam unë I pari që nuk kam dashur që çmimi I biletës të rritet por kjo do të na sjelli automatikisht edhe në dështimin apo mbylljen e ktyre bizneseve pasi nuk ka leverdi ekonomike. Që sot ai të vazhdojë të punojë me humbje automatikisht është ai shqetësimi që ne kemi patur përherë që kur ato gjejnë një hapsirë orari edhe mund ta kufizojnë atë lëvizje pra të reduktimi orarit dhe gjithashtu nuk ofrohet një shërbim I mirë për qytetarët. Kemi një grup monitorimi nga bashkia Elbasanit të cilët janë përgjegjës për monitorimin e linjave. Është një sektor tek Agjensia e shërbimeve publike I cili merret vetëm me monitorimin e transportit public që shikon oraret, cilësinë etj. Në momentin që ne do marrim këtë masë patjetër që subjektet duhet të jenë më koshiente të gjitha për respektimin e orarit, për futjen e mjeteve të reja të transportit megjithatë është edhe ky problem tjetër që në 2027 të gjitha liçensat 10 vjeçare mbarojnë dhe patjetër që edhe subjektet vetë kanë ngurtësinë e tyre për të bër investime sidomos në zonat rurale për investime në mjete të reja apo ato që janë më të përafërta me standartet e Bashkimit European. Patjetër monitorimi do jetë më I madh port ani jemi para këtij fakti, do indeksojmë një çmim apo nuk do ta indeksojmë dhe do ta lemë ashtu siç ishte në 2017. Asnjëri nga Anëtarët e Këshillit Bashkiak apo unë që jam Kryetari I Bashkisë nuk kam vullnet politik për të ngritur tarifat por nga ana tjetër duhet të marrim parasysh edhe ato të cilët e ofrojnë këtë shërbim. Vazhdon na rritet numri I makinave private, vjet na është rritur me 8.000 makina dhe kuptohet që në momenr që rritet fluota e makinave private, transporti public fillon dhe reduktohet. Në gjithë Europën trasnsporti publik subvencionohet ose subvencionohet nga Bashkia. Ka shumë modele të ndryshme të funksionimit të transportit public. ka modele ku Bashkia ka autobuzët dhe I menaxhon privati ose modele ku autobuzët I ka privati dhe Bashkia mer vetëm shërbimin dhe të ardhurat I kalojnë Bashkisë. Ka dhe modele siç jemi ne që e japim me liçensë këtë gjë ku edhe transporti edhe shërbimi edhe të ardhurat janë risk I subjektit I cili ka linjën e transportit. Nuk janë kompani të mëdhaja, janë biznese të vogla familjarë përgjithsisht të cilat përpiqen të kenë një ekonomi të tyre ku dhe të ofrojnë shërbimin për banorët e tyre ku ata jetojnë apo operojnë.

Këshilli Bashkiak me 31 vota pro, - kundër, 6 abstenim, miraton sa më sipër.

(M.Kaçuli;A.Shtylla;E.Muzhaqi;D.Madhi;V.Balliu;A.Meçja)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 17 e rendit të ditës

17. Për indeksimin e tarifave të shërbimit taksi në Bashkinë Elbasan.

Këshilli Bashkiak me 31 vota pro, 1 kundër, 6 abstenim, miraton sa më sipër.

(A.Kana)

(M.Kaçuli; A.Shtylla; E.Muzhaqi; D.Madhi; V.Balliu; A.Meçja)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 18 e rendit të ditës

18. Transferim fonde në buxhetin e vitit 2025, për DPKS

Shefqet Bullari -Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Për buxhetin e vitit 2025 kemi miratuar 1 milion lekë të reja për koloninë e piktorëve por realisht Drejtoria e Teatrit Skampa ka bërë një kërkesë, një domosdoshmëri për ndriçimin e fonisë, prozhektorët dhe kërkon kalimin e kësaj 1 milion-shi nga kolonia e piktorëve tek ndriçimi i teatrit.

Këshilli Bashkiak me 31 vota pro, - kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

(E. Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 19 e rendit të ditës

19. Për shpalljen e përfundimit para afatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Z. Blendi Himçi

Këshilli Bashkiak me 34 vota pro, - kundër, - abstënim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.07.2025, ora 13:14 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, Nen kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media dhe Administratori I Eco-Elb Sh.a

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Miratojmë piken e 3 tek të ndryshmet pastaj vazhdojmë tek 2 pikat e tjera pasi duan më shumë kohë për të diskutuar.

Të ndryshme

3. Diskutimi I analizës se barometrit të barazisë gjinore (30%) viti 2024. Adresimi I zbatimit të 24 detyrimeve ligjore për barazinë gjinore në Bashkinë Elbasan.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kalojmë tek dy pikat e tjera ku një grup këshilltarësh kanë kërkuar që mbledhjen e mëparshme një interpelancë me Shoqërinë Eco-Elb Sh.A lidhur me situatën aktuale të inceneratorit. I pranishëm është përfaqësuesi i Shoqërisë. Përpara se të fillojmë duhet të biem dakort të ketë një përfaqësues nga ju do të diskutojë 3-5 minuta pastaj të dëgjojmë përfaqësuesin sepse ata pyetjet I kanë.

1. Interpelancë me shoqërinë Eco-Elb për të diskutuar situatën e krijuar pranë vendgrumbullimit të mbetjeve

Bianka Çopja-Anëtare e Këshillit Bashkiak

Kryetari duhet të jetë prezent. Kemi kërkuar përfaqësues edhe për Bashkinë edhe për Shoqërinë Eco-Elb. Të nderuar koleg këshilltarë ju përshëndes të gjithëve, si ato me maska në fytyrë si ato pa maska, të maskuar pas njëri tjetrit për një gjë që na dhemb të gjithëve. Jo më larg se data 30 Maj e vitit 2025 paralajmërova qartë se vendgrumbullimi I mbetjeve përbënte një rrezik real dhe donte një ndërhyrje të menjëhershme dhe mos ndodhin kto që ndodhën. Megjithatë kjo thirrje u injorua dhe ju si çdo vit vazhduat e injoruat një kontratë tërësisht abuzive dhe të dëmshme për qytetarët, për mjedisin dhe për mbarëvajtjen e qytetit të Elbasanit. Asnjëherë

deri më sot nuk kam drejtuar gishtin ndaj individëve, kam zgjedhur të mbaj një qëndrim institucional larg sulmeve personale por gjithnjë në shërbim të së vërtetës dhe interesit publik. Sot, arrogance, babzia dhe mendimi për të gënjer se diçka po bëhet janë të dukshme dhe nuk mund ti fshini më. Kam dëshiruar dhe shpresuar që kjo çështje të mos përdorej për përfitime politike por ë trajtohej si një kauzë qytetare jetike për shëndetin dhe mirqënien e qytetarëve. Pasi unë dhe kolegët e mi zbuluam dhe mësuam këtë skemë të dëmshme, u përpoqet me çdo mjet të fshinjtë gjurmët, të manipulonit të vërtetën, por ju siguroj vetëm diçka se koha do nxjerr në dritë gjithçka. Jo besoj shumë larg do të vij momenti ku secili do të përballlet me përgjithsitë e veta dhe së fundmi kam disa pyetje, meqenëse Kryetari I Bashkisë për momentin ka lëvizur, I drejtohem disa pyetje drejtuar Administratorit të Eco-Elb Sh.A Zotit Leli Kaja.

Zoti Kaja në cilësinë tuaj si Administrator I Shoqërisë Eco-Elba Sh.A, çfarë masash duhet të ishin marrë për të parandaluar përsëritjen e situatës së grumbullimit dhe shpërndarjes së mbetjeve që ka sjellë ndotje të ajrit për komunitetin? A keni informuar zyrtarisht Institucionet për rrezikun dhe si e justifikoni mosmarrjen e masave për këtë situatë e cila është përsëritur disa herë ndër vite?

Leli Kaja-Administrator I Shoqërisë Eco-Elb Sh.A

Përsëritje të gjithëve. Në detyrën e Administratorit të Shoqërisë Eco-Elb Sh.A, siç edhe jeni njoftuar në datën 01 Korrik 2025, pranë sipërfaqes së landfillit ka rënë një zjarr dhe zjarri ka qenë për shkak natyrore dhe këtë e themi ne dhe kështu besoj është, pastaj janë organet e tjera të cilat po hetojnë. Nëse ka përgjithsi, secili do mbajë përgjegjësi. Në rradhë të dytë siç ka thënë edhe Kryetari I Bashkisë, ne i kërkojmë falje qytetarëve, ne kemi bërë aq sa kemi mundur dhe jemi munduar të bëjmë maksimalen pavarësisht se nga të dy palët si nga Partia Demokratike ashtu edhe nga Partia Socialiste, të gjithë partitë bashkë jemi këtu nuk jemi bërë bashkë për të dërguar një shkresë diku. Ato I kam bërë vetëm unë, pavarësisht se kam dalë nga korniza ligjore që më takon por jo është një diçka për tu parë. E dyta në lidhje me pyetjen që bëri zonja, unë po them që kam dërguar letra në shumë ministri, kam dërguar shkresa direkt Kryetarit të Bashkisë pasi unë pronar kam Kryetarin e Bashkisë dhe pse nuk është bërë apo pse nuk po bëhet po punohet për tu parë dhe le ta gjejnë ato që duhet ta gjejnë. Unë si detyrë kam njoftuar dhe kam detyrë ligjore

të njoftoj, deri ktu jam, njëkohësisht të marrë edhe masa nga ime. Nga ana e punonjësve është bërë lagia me ujë sepse ne këtë mundësi kemi, përditë me hidrantet që janë atje. Hidrantet atje nuk janë për një sipërfaqe aq të madhe sa ka arritur sot landfilli por janë për një sipërfaqe më të vogël, pavarësisht se ne i kemi zbratur disa herë dhe i kemi mbushur gjatë ditës për të bërë lagien me ujë. Pika ka arritur kritike në situatën ku jemi, por do zgjidhet, presim përgjigje nga qeveria që të zgjidhet dhe duhet ndërtuar një landfill i ri, pasi ky landfill ka kaluar kapacitetet e veta dhe nuk kemi se ku të hedhim më mbetje. Jemi në fazë kritike sa ka arritur të shembë edhe disa skarpata anësore të kësaj landfilli. Kjo është pjesa kryesore. Ne si shoqëri jemi munduar të bëjmë më të mirën pavarësisht situatave që dalin. Kto histori që dalin jo e dogjën jo se dogjën, janë muhabetë që secili ka bindjen e vet dhe unë nuk mund të ndaloj njeri që të arrij deri ktu. Masat që duheshin marrë janë duhet ndërtuar një landfill i ri tjetër sepse ka kaluar kapacitetet ky që është aktual. Kjo është masa kryesore sepse ndërtimi i një landfilli të ri ose shtimi i landfillit. Edhe njëherë tjetër është për këtë arsye, masat ne po i marrim, bëjmë lagien me ujë përditë, bëjmë mbulimin me dhe, bëjmë ngjeshjen e atyre mbetjeve që vijnë por derisa vijnë 150 ton mbetje në ditë, ne nuk kemi çfarë të bëjmë më shumë. Ne bëjmë maksimumin e asaj që na lejon ligji. Unë këtë e kam me shkresë, jo sot po me shkresë të kaluara. Ju nëse keni ndonjë gjë na sillni shkresën e tju japim përgjigje.

Bianka Çopja-Anëtare e Këshillit Bashkiak

Pse i shmangeni pyetjeve?

Leli Kaja-Administrator i Shoqërisë Eco-Elb Sh.A

Jo unë nuk po i shmangem, nuk kam ardhur të bëj debat me juve, ju debatin bëheni me njëri tjetrin se unë po shpjegoj situatën ligjore. Sipas pikave që keni kërkuar do ju jap përgjigje. Po të jap përgjigje edhe pak më tepër dhe po tregoj situatën korrekte si është dhe nuk kam pse të them ndryshe sepse unë se kam punën personale, e kam punën e shtetit dhe jam korrekt me ligjin dhe me njerëzit. Për atë që më takon do mbaj përgjegjësi patjetër kështu që rri pa merak, ti shiko të zgjidhësh problemin dhe ju bashkë për qytetarët e Elbasanit po kush ka bërë gabime le të mbajë përgjegjësi. Unë them për të mirën e qytetit pastaj për çështje personale jemi mësuar ne. Le të shajnë nuk ka problem. Unë ju përgjigja pyetjeve sipas kërkesave që keni bërë.

Bianka Çopja-Anëtare e Këshillit Bashkiak

A ekziston aktualisht në impiantin Eco-Elb një sistem hidrant funksional për fikjen e zjarrit?Nëse po, a është një sistem I çertifikuar nga organet kompetente për siguri teknike dhe zbatimin e normave të mbrojtjes nga zjarri?Sa mjete të lëvizshme për fikjen e zjarrit disponon kompania në të gjithë territorin e saj dhe a janë të çertifikuara, në gjendje pune?A ka Eco-Elb një strukturë ose etikë emergjencash të ngritur sipas standarteve ligjore për menaxhimin e situatave të zjarreve dhe fatkeqsive?A janë punonjësit e Eco-Elb të trajnuar për rastet e zjarrit sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi?Së fundmi, në vlerësimin tuaj teknik si mund të ishte shmangur situata aktuale e zjarrit dhe masimit të djegur të mbetjeve, çfarë masash konkrete duhet të kishit marrë më herët siç ka ndodhur edhe në raste të tjera evidentuese.Kto pyetje kemi kështu që besoj përgjigjet I keni gati.

Leli Kaja-Administrator I Shoqërisë Eco-Elb Sh.A

Neve kemi 3 pyetje që janë dorëzuar në Këshillin Bashkiak dhe sipas Kryetarit të Këshillit Bashkiak ne na është sjellë një shkresë dhe pyetja e 1 është rrethanat e incidentit nga ana juaj, masat e marra nga Shoqëria, planifikimi për parandalimin e incidenteve të ngjashme në të ardhmen.Unë këto pyetje kam, për të tjerat...edhe njëherë unë jam I gatshëm ti përgjigjem çdo lloj pyetje dhe nuk jam shmangur asnjëherë pyetjeve por unë flas çfarë më ka sjellë sekretaria e Këshillit Bashkiak dhe nuk mbaj përgjegjësi për pjesën tjetër.Për këto 3 pyetje unë përgjigjet I kam dhe nëqoftëse doni diçka më shumë më sillni me shkrim se unë nuk jam përgatitur për të gjitha pyetjet.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Znj.Bianka nuk e kuptoj çfarë pyetjesh kërkon ti akoma,3 pyetjet I ke ktu,te lista që është firmosur nga 19 Antarë Këshilli

Leli Kaja-Administrator I Shoqërisë Eco-Elb Sh.A

Nuk ka problem, mi sillni me shkrim ato pyetjet edhe unë ju kthej përgjigje.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ju garantoj, është e sigurtë kjo që them

Leli Kaja-Administrator I Shoqërisë Eco-Elb Sh.A

Unë jam në interpelancë për kto pyetje që keni bër dhe për ato që ka sjellë sekretaria e Këshillit Bashkiak. Punonjësit që kemi ne pranë janë të certifikuar për situata të tilla dhe kjo është me document që po them unë. Nëse keni pyetje të tjera sillini me shkrim, nuk kemi asnjë lloj problem. Aktualisht është bërë kapsulim i pjeshëm i gjithë mbetjeve që ishin atje, nuk ka rrezikshmëri për zjarre aktualisht nga pjesa që ka qenë, por duke hedhur mbetje në po të njëjtin vend me prespektivë mund të kemi edhe rrezikshmëri të tjera nëse nuk do ndërtohet një landfill tjetër. E kemi bërë kapsulimin herë pas here, ne bëjmë kapsulim të pjeshëm dhe kjo është një detyrë e përditshme pastaj për gjithë sipërfaqen nuk është bërë kapsulimi por është bërë kapsulimi për ato që ngjeshëm. Për më shumë jam i gatshëm tju përgjigjem me shkrim për pjesët e tjera veç pyetjeve që keni. Ju falenderoj dhe respekto

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ka një rregull, përfaqësuesi i grupit i cili juve kërkuat interpelancë ka të drejtë 3-5 minuta të fliste dhe të kërkonte arsyetim për ato që kishte. Pas atij ishte e detyruar që Leli të jepte përgjigje. Edhe njëherë, ju të katërta nuk po lini rradhë të flisni me njëra tjetrën apo kolegët tuaj

Zamir Muzhaqi – Zv. Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Unë doja ti kujtoja diçka drejtorit po fatkeqsisht e vendosi drejtori se si zhvillohet interpelanca dhe jo antarët e Këshillit Bashkiak. Përfaqësuesi i Eco-Elbit tha që do ti japë përgjigje 3 pyetjeve por i dha përgjigje dhe 1 pyetje politike që nuk ka të bëjë fare me Drejtorin e Eco-Elbit. Përmendi që antarët e të dy partive politike nuk janë bërë pjesë e zgjidhjes emergjente për qytetarët e Elbasanit. Unë nuk e paragjykoj për mashtrim, doja t'ia thoja në sy po meqë iku ta ngjojë te telefoni. Është një mashtrim pasi kemi muaj të tërë me rradhë që Antarëve të Këshillit Bashkiak të krahut të majtë i kemi bërë thirrje që të bëhemi të gjithë bashkë dhe ta gjejmë një zgjidhje për këtë emergjencë për qytetarët e Elbasanit. Bëjmë një presion pozitiv, si Këshill Bashkiak që të kërkohej një zgjidhje imediate për çështjen e mbetjeve sidomos për vend depozitimi sepse atë kemi në dorë. Incenerimi u mor vesh, është një plagë e madhe sepse merret vesh çfarë po ndodh. Ju kam bërë thirrje disa herë që ju lutem të gjithë Antarët e Këshillit të jemi të gatshëm që të ushtrojmë këtë presion për mënyrën sesi duhet ta zgjidhim. Një zgjidhje ishte kërkesa për një landfill të ri, ndoshta është më realistja, më imediatja dhe hajde ta bëjmë atë

kërkesë. U bën kaq muaj që nuk kemi një përgjigje nga ana e këshilltarve tuaj pra hajt ta bëjmë këtë kërkesë të gjithë si këshill, hajde ta vem Kryetarin e Bashkisë në presion, I gjithë si këshill sepse është një problem që I duhet dhënë zgjidhje. Nuk po diskutoj për incenerimin, incenerimi ka mbaruar që ditën e parë dhe këtë e dimë ne. Ky qytet do zgjidhje dhe hajde bëjmë presionin e duhur për të bërë një landfill të ri. Mesa jemi në dijeni nga drejtori para dy tre muajsh kur kaloi buxheti, na vuri në dijeni që ai e ka një plan, një projekt të landfillit. Të bëhemi bashkë e të paktën të filojmë me landfillin se ajo puna atje do vazhdojë e sdihet ku e ka përfundimin. Është një mal I cili ka leje mjedisore 25 mijë ton dhe është gati 250 mije. Kisha dhe pyetje të tjera po fatkeqsisht e bëri ai zgjedhjen, jo ne. Me atë fjalën e drejtorit jo jemi të partisë jo sjemi të partisë, kjo nuk është një çështje që e kalon partinë.

Bukurosh Stafa-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Problemi I mbetjeve është një problem madhor, ne jemi pak më të vjetër dhe të gjithë e dimë si ka qenë tek varrezat. Problemi se si mori, se si u bë, ktu Bashkia nuk ka pas vënd, nuk ka patur dorë. Po gjithsesi ajo çështje është në ndjekje penale dhe atë organet ligjzbatuese do ta ndjekin dhe do vënë dënimet e duhura dhe do vazhdojnë ta ndjekin. Mendoj që nuk është vëndi ktu të diskutojmë e ka fajin ky apo e ka fajin ai. Kush ka përgjegjësi do mbajë përgjegjësinë. Jemi pak më mirë sesa në fillim po prap situatë është emergjente dhe unë pajtohem plotësisht që ne si Këshill Bashkiak të propozojmë përmirsimin e situatës. Jam dakort për vendgrumbullimin e ri. Të na sjellin propozimet konkrete ktu që ne ta shikojmë e ta miratojmë.

Valbona Balliu-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Përsa I përket hetimit penal dhe auditit I jashtëm Teknik, kjo situatë I ka kaluar kufijtë e këtij këshilli. Unë do të doja që ky këshill të ngrihet një herë të vetme në lartësinë e duhur. E falenderoj Zotin Stafa që për herë të parë bëri një fjalim të singertë dhe kështu duhet të funksiononte ky këshill. Nëse do të funksiononte me kto parametra, ne sot do të kishim parandaluar këtë situatë të papqlyeshme për qytetin tonë. Atëherë 1-Transparenca totale te qytetarët dhe drejt kontratave dhe transparencë kundrejt kontratave dhe faturave që do të thotë që nëse ne do ti bëjmë kto, në të gjitha situatat në vazhdim besoj që secili drejtues do jetë më I kujdesshëm në atë çka përfaqëson dhe 2-Komision mbikqyrës nga Këshilli

Bashkiak që janë për çdo vendimarrje të ardhshme të kësaj rëndësie që ka të bëjë me mbetjet ose me situata të tjera të cilat kanë përparësi të veçanta dhe ndikojnë në jetën e drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve.

Zoti kryetar do të doja që ju të kishit paraqitur një strategji rajonale në menaxhimin e mbetjeve dhe në ndarjen e barrave. Të rrijë pastër Cerriku me një numër të kufizuar banorësh, Gramshi, Prrenjasi, Rogozhina dhe një qytet si Elbasani me kaq resurse sa ka Elbasani të kthehemi në depo mbetjesh? Përderisa incineratori nuk punon atëherë çfarë do bëjmë ne? Unë mendoj që duhet të ndahet barra dhe përderisa ky incinerator nuk prodhon energji për të djegur plehra pra mbetjet landfillohen dhe jsnë burim I vazhdueshëm ndotjesh kjo duhet të marri patjetër zgjidhje emergjente. Dhe në fund një fushatë informimi dhe ndërgjegjsimi I qytetarëve për ndarjen e mbetjeve dhe rregullsinë e mbetjeve. Unë mendoj që ne të gjithë bashkë ktu duhet ti japim një zgjidhje qytetit tone pasi është detyrë që na e kanë besuar votuesit tanë. Duhet të kemi ura bashkëpunimi për të mirën e qytetit. Jo gjithçka është biznes, ka dhe moral, ka dhe shëndet se fundja dhe ky zotëria këtu merr ajër, dhe ne të gjithë këtu frymojmë, dhe fëmijët tanë këtu frymojnë prandaj në çështje të tilla kaq sensitive ta lëm jashtë politikën dhe të bëhemi bashkë për këtë qytet. Faleminderit!

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Nëqoftëse kërkon politikë bëjmë por interpelanca ka një rregull. Përfaqësuesja e anëtarve kishte të drejtën dhe foli dhe mbas asaj do jepte përgjigje personi që ishte në interpelancë. Tani po humbni kohë dhe po përsërisni të njëjtat gjëra. Kështu që këtë interpelancë me këtë temë e quaj të mbyllur.

Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Ti nuk e di çfarë do flisja unë, do ti thoja Kryetarit të Bashkisë që mund ti jepte përgjigje më mirë se ai që ishte përpara. Interpelanca nuk ka as numër pyetjesh, as çuarje pyetjesh. Më vjen shumë këq për juve gjithsesi është e papranueshme që largohet personi përgjegjës në thonjza se nuk është I vetmi përgjegjës. Në fakt Eco-Elbi është një shoqëri aksionere dhe duke qenë një shoqëri aksionere bashkë me administratorin ka një bord administrimi I cili mer vendimet në emër të shoqërisë me firmën e administratorit dhe me bekimin e pronarit që është Bashkia

Elbasan që e ka vendosur këtë bord. Zotëria që sapo iku ja shkarkoi të gjithë përgjegjësinë pronarit, nuk e ka pronari e ka bordi, kështu që bashkë me atë sot duhet të ishte dhe bordi që duhet të jepte përgjigje. Kjo problematikë e madhe që neve e pamë në formën e një zjarri, brenda vitit e kemi parë 3 herë, edhe muajin tetor të vitit të kaluar kur temperaturat ishin 16 gradë dhe nuk kishte asnjë lloj arsye pse duhet të binte zjarri. Nis nga një abuzim financiar dhe duhet të zgjidhet po me një rregullim financiar. Pronari ka dhënë 7 miliard lekë edhe vazhdon ja jep inceneratorit që nuk është incenerator. Te analiza e kostove që na solli nga një shoqëri e pavarur herën e kaluar për miratimin e Kostos së incenerimit të mbetjeve për ton, na ishte paraqitur një analizë e cila kërkonte rritje kostosh, rritje të pagave të punonjësve, rritje të kostove të administrimit, rritje së çmimit të përpunimit të lëndëve parësore që përdoren në incenerim ndërkohë që incenerim nuk ka. Tani o zoti pronar duke qenë se ska incenerator, pse nuk e merni ju iniciativën e krijimit të një landfilli të rid he mos ja transferoni më kësaj kompanie Eco-Elb Sh.A të gjithë ato lekë të cilat janë destinuar prej vitesh dhe përkon prej 3 vite inceneratori ska punuar 1 javë. Pse lejoni që të vijmë në Këshillin Bashkiak analiza kostosh me skenare të ndryshme, që janë analiza fiktive nga agjensi të jashtme, ndërkohë që inceneratori inekzistent ka një bord administrimi. Ajo e incenerimit që kishte koston 26 euro...jam shumë e saktë unë kur flas me terma...ju vazhdoni ta quani incenerator por nuk është incenerator prej 3 vitesh, është landfill dhe sot është shtuar dhe Bashkia Rrogozhinës. Për aq kohë sa je pronari I ligjshëm dhe ke të drejtë të ndikosh në vendimet e administrimit të kësaj Sh.A-je, pse kto 7 miliard lekë që jep vit për vit nuk I përdor në një mënyrë më efikente? Ku I gjeta unë? Po I ke futur ti në buxhet. Pse në analizë kostoje nuk na keni sjellë një herë të ardhurën që gjenerohet nga riciklimi I kartonit. Në xhep të kujt ka ik e ardhura nga riciklimi kartonit?

Hektor Çiftja-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Absolutisht e mirkuptoj që partia demokratike ka shqetësim. Përfaqësuesit e opozitës që janë këtu kanë 2 elemente :elementin e shqetësimit të cilin ne si socialistë e kemi po aq shqetësues siç e shprehu dhe Zoti Bukurosh Stafa, ka dhe elementin e propagandës. U ngrita vetëm si kryetar I grupit të bëj një propozim nëse mund të biem dakort me Kryetarin e Bashkisë dhe Kryetarin e Këshillit Bashkiak dhe përfaqësuesit e këshillit. A është e mundur të ngremë një grup pune, jo për të parë nga e kaluara por një grup pune që kto propozimet tuaja të jenë

me shkrim.në këtë grup pune të bëjë propozime konkrete se si ta zgjidhim problemin e landfillit dhe se si të llojmë për atë duke qenë se kemi një vendim të Këshillit Bashkiak të propozuar nga ju, të miratuar nga ne për një landfill ekstra për çdo rast emergjence.Pra ne bazën ligjore e kemi, dhe shqetësimin e kemi.Mund të shënoni këtë propozim për këtë grup pune të Këshillit Bashkiak me përfaqësues të dy palëve, të bëjmë një komision të mblidhemi sa më shpejt me propozime konkrete.Unë kisha këtë propozim, ua të mbahet dhe mbase të miratohet sot ose të hidhet poshtë sot.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Nuk ka çfarë miratohet por duke filluar që nga sot, atë që juve thatë unë do kisha dëshirën që secili nga jut ë sillte propozimet deri në datë 15 ne jemi në dispozicion.Ti sjellin pastaj krijojmë komision e bëjmë.Fjala për Zotin Muzhaqi.Zonja Valbona nuk ka asnjë sekondë më,kanë gjithë ditën që të dëgjojnë ty, do flasin dhe të tjerë.

Ergys Muzhaqi-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Ne 19 antarë të këshillit Bashkiak të opozitës kemi kërku interpelancë në mbledhje jashtë rradhe.Për mbledhjen jashtë rradhe nuk pati prezencë fare të antarëve të partisë socialiste dhe më vjen shumë keq për këtë.Kemi thirr Kryetarin e Bashkisë që fatkeqsisht der tani si kemi dhën fjalën të flasi, për respekt të pozitës që ka ta lejojmë të flasi, administratorin e Shoqërisë Eco-Elb I cili iku shumë shpejt mbasi foli me veten dhe përgjegjës të teknik të Shoqërisë Eco-Elb.Qëllimi I interpelancës ka qen:sqarimi I rrethanave të incidentit që deri tani është thënë që besojmë se është aksidental për procedurë.Marrja e përgjegjsive pika e dytë dhe planifikimi I masave për parandalimin e incidenteve të ngjashme në të ardhmen.As nuk u mor përgjegjsi, as nuk u tha ndonjë plan por jam shumë I vetdijshëm që dhe dy kolegët e partisë socialiste që morën inisiativën, që më në fund flasin për diçka ndryshe për plehrat e qytetit se deri tani kan thënë hajde ta votojmë, ngri dorën për çfarë?Nga 25 mijë lekë toni ta bëjmë 26 mijë lekë.Përsa I përket elementëve me shkrim padyshim që ne kemi bërë kërkesa me shkrim, mjafton të hani procesverbalin e mbledhjeve të këtij këshilli kur unë personalisht kam thënë:Nuk pranoj të negocioj e të diskutoj në këtë këshill për asnjë lloj gjëje tjetër, rritje apo ulje tarifash përveç se për transferimin e grumbullimit të plehrave në një vend alternativ që është Papri.Ky është propozimi im.E kam dhe mediatic po të paktën e kemi zyrtar këtu.Ju lutem

Zoti Llatja, e kuptoj që përgjegjsia teknike nu ka pse të hyje ty, por sigurisht që ktu ka një përgjegjsi politike dhe shpresoj që të keni një përgjigje për 3 pikat që ne kemi kërkuar, interpelancën jemi 19 veta që e kërkuam dhe më vjen keq që është zvarrit kjo punë, dhe më vjen keq që të gjithë vuajnë.Zoti Luti të flasi Kryetari I Bashkisë

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Pyetjeve teknike iu është përgjigjur administratori I shoqërisë,nëse keni pyetje shtesë mund ti bëni përsëri,vjen prapë herës tjetër nëse keni pyetje të tjera.Jam shumë dakort me propozimin.Jemi interesuar për pjesën e Paprit që keni thënë në vazhdimësi, jemi interesuar ajo është leje minerare aktive, pjesa mbrapa ka qen dampa e vjetër e Metalurgjisë,sot është leje minerare active dhe ka një kompani e cila e shfrytëzon këtë si mineral.E shoh ligjërisht dhe teknikisht shumë të vështirë që aty të bëhet një landfill I ri, të paktën në kushtet që jemi ne,mund ta parashikojmë për të ardhmen kur të mbarojë leja minerare apo nëse leja minerare nuk plotëson kushtet.Me informacionin që kemi ka patur rinovim të lejes minerare dhe atje në atë lokacion ku ka qen dampa e vjetër e shoh momentalisht në një kohë të shkurtër 1 vit apo 2 vite që aty të vendoset një landfill I ri.Kemi kërkuar dhe në ministry zgjerimin e landfillit ekzistues.Landfilli ekzistues para se të bëjë këtë pjesën e teknikalitetit duhet të fitojë pak dhe pjesën e politikave pasi ka një strategji për menaxhimin e mbetjeve në Republikën e Shqipërisë dhe është një strategji e miratuar nga pjesa qendrore.Në atë strategji është e përcaktuar vendi se ku do depozitohen mbetjet për të gjithë zonën e mbetjeve të Elbasanit.Rrogozhina është pjesë e mbetjeve të Elbasanit, jo e qarkut po e zonës së mbetjeve.Aty është imjanti I trajtimit të mbetjeve në Elbasan dhe ajo që ne kemi kërkuar në vazhdimësi është që të shihet mundësia e zgjerimit të landfillit ekzistues.Kemi mëse 3 vjet që e kërkojmë këtë.Ne kemi detyrimin ligjor si Bashki të çojmë mbetjet në atë vend, në impjantin e trajtimit të mbetjeve.Problemi kryesor që kemi atje sot është zgjerimi I landfillit ekzistues dhe për shkak të mbingarkesës që ka patur gjatë gjithë kësaj periudhe për shkak të mospunimit në kohë të inceneratorit të Elbasanit I cili bënte djegien e një pjese të mbetjeve.Jam shumë dakort me të gjithë ju që të ngrejmë një komision pasi gjithçka ka një kosto financiare .Kemi një planifikim mesa di unë te buxheti për të marrë masa shtesë .Financiarisht e kemi të pamundur të bëjmë një landfill të ri, ju I keni parë buxhetet e Bashkisë dhe momentalisht e kemi të pamundur financiarisht që ne të mbështesim ndërtimin e një landfilli të ri prandaj I

kemi shtrirë dorën bashkëpunimit të qeverisë Shqiptare dhe kemi kërkuar që të bëhet landfill I ri. Jemi të gatshëm të bëjmë çfarë do lloj studimi bashkë me Këshillin Bashkiak ose dhe lokalicione të tjera. Ne kemi bërë një studim para disa kohësh për zonën e mbetjeve të Elbasanit dhe janë parashikuar edhe pika të ndryshme të transferimit për Bashki të ndryshme, të Belshit, të Librazhdit, Prrenjasit, Rrogozhinës, Peqinit dhe aty janë përcaktuar edhe vendet e depozitimit të mbetjeve si të inerteve ashtu edhe atyre të gjelbërta të krasitjeve të pikës së kostimit, janë pika transferimi, është tjetër gjë pika transferimi dhe tjetër gjë impjanti. Pika e transferimit mbahet 24 orë aty deri në 48 orë dhe pastaj mblidhet me makinat e tjera të mëdhaja dhe kalojnë në landfill. Jemi duke diskutuar edhe me agjensinë e mbetjeve për të patur mundësinë sa më shpejt të krijimit të këtyre qendrave të trajtimit të mbetjeve pasi aty është edhe një mundësi që të bëhet një paraselektim i mbetjeve që vijnë në impjantin. Sot përveç atyre që mblidhen nga bizneset vet, sidomos kur janë mbetje të riciklueshme, kemi kontratë edhe për vajrat, gomat. Janë një sërë mbetjesh të cilat vetë bizneset nuk i hedhin në mbetje por ja lënë kompanive të tjera ti marrin pra kanë kontrata me kompani të tjera. Duhet të fillojë një fushatë sensibilizuese për shumë biznese dhe familje për të ndarë mbetjet sipas planit të ri që kemi bërë. Të fillojmë me disa zona sidomos ajo e kalasë dhe disa zona periferike të qytetit. Të fillojmë me dërgimin e qeseve plastike për ndarjen në burim dhe pastaj edhe për tërheqjen e tyre. Kjo bëhet fjalë për vitin tjetër, jemi duke përgatitur në bazë të strategjisë që kemi miratuar në Këshillin Bashkiak për mbetjet. Jemi duke bërë gati edhe dokumentacionin përkatës ligjor për procedurat përkatëse që kërkojnë për tërheqjen. Jam shumë dakort dhe e shoh shumë me vlerë që të ngrihet një komision nga Këshilli Bashkiak në mënyrë që të jetë edhe ai më shumë koherent. E kuptoj të gjithë pjesën e gjësë që bëhet më shumë politike dhe të ngarkesës që do të marri gjithsecili nga antarët e këshillit por është e mira që të jenë një komision i cili mund të interesohet, mund të ketë një të dhënë edhe të gjejmë një zgjidhje apo një mënyrë se si do të shkojmë deri tek pjesa e zgjerimit të landfillit. Nuk e di në isha i saktë po besoj për të treja pyetjet u përgjigja. Aty ka patur mbetje vet në natyrë, nuk e di sepse sjam ekspert i kriminalistikës as ekspert i zjarreve as ekspert i zjarrfikseve por një gjë e di që kam diskutuar me ekspertë të ndryshëm të landfillëve, kur janë mbetje të ndryshme të cilat janë mikse dhe vet landfilli ka një kohë të caktuar. Ne nuk duhet të harrojmë që në landfillin tonë janë hedhur të gjitha mbetjet që kanë qenë të fushës tjetër të mbetjeve të Elbasanit, janë transferuar aty dhe flitet për mbetje të cilat kanë

afërsisht 20 vjet të cilat kanë vet procesin e dekompozimit në pjesën fundore. Ato arrijnë një maturi dekompozimi për të prodhuar gaz me to. Gazi metanit I cili çlirohet në landfill derisa të mbyllet të bëhet kapsulimi, ai vazhdon të jetë në prodhim pra prodhon vet landfilli gaz metan. Mund të jenë shumë arsye që çojnë në zjarrin. Ka patur raste që kanë qenë zjarre më të vogla, janë kapur në kohë dhe kanë arritur ta menaxhojnë në kohë situatën. Ka shumë mënyra që të bjeri zjarri, mund të bjeri nga një bateri, nga gazi metan dhe kjo do të zgjidhet vetëm pasi të bëhet kapsulimi total I landfillit, të shpohet në çdo 5 metra tubi I çlirimit të gazrave të metanit. Kjo është një procedurë që bëhet më pas mbylljes së landfillit, do të jemi të gatshëm në momentin e mbylljes së landfillit. Landfilli I ri është I domosdoshëm, shtesa e landfillit ekzistues, edhe landfilli I ri ndoshta po të përcaktohet një vënd edhe sipas standarteve. I kemi disa standarte ligjore të cilat janë përcaktuar për landfillin, I kemi të gatshëm dhe në momentin që krijojmë një grup komisioni të përbashkët ku sëbashku të dalim të flasim të shohim, të bëjmë një kosto ekonomike, të flasim me banorët e zonës, të shohim rëndësinë e saj dhe të gjejmë një zgjidhje nëse do të duhet për ndërtimin e landfillit të ri në një pozicion tjetër apo zgjerimin e landfillit ekzistues.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Faleminderit, kalojmë tek pika e fundit e cila ka të bëjë me Zotit Muzhaqi përse I përket ujësjellësit.

2. Interpelancë me shoqërinë UKE për dhënie informacioni për situatën tenike të punimeve

Ergys Muzhaqi-Anëtar I Këshillit Bashkiak

Faleminderit, këtë interpelancë unë e kam kërkuar në mbledhjen e fundit të rradhës, faleminderit që e keni fut sipas kërkesës time në këtë mbledhje. Kam kërkuar interpelancë me përfaqësues Teknik dhe politik të Bashkisë po ashtu Teknik të firmës apo firmave zbatuese. Këto projekte po bëhen prej kaq kohësh në qytetin e Elbasanit pra kemi një seancë ku dhe unë dhe kolegët e mi e kemi artikuluar në këshill dhe jashtë këshillit. Kemi punime të vazhdueshme prej më shumë se një viti në qytet dhe ne duam informacion për kushtet e kontratës, sa do zgjasin këto punime. E dimë që kanë qenë të caktuara deri në prill, ku do shtriheshin, çfarë

kushtesh kishin.Di të them që edhe muajin e kaluar gjatë mbledhjes tonë, ndërkohë që ne flisnim hapesh kanal krahas ambjentit që ne bëjmë mbledhjet.Vazhdon kanali nuk është mbyllur,disa edhe mbyllen, disa rihapen prapë.Pra kjo anulli që është kriju në qytet prej shumë kohësh,që ka krijuar pluhur kur është vapë, baltë dhe mungesa e furnizimit me ujë sipas informacionit të disa zonave të qytetit është e padrejtë.Sigurisht edhe me mbështetjen e shumë kolegëve të mi, duam ti jepet një sqarim Këshillit Bashkiak nëpërmjet nesh.Qytetarët na kanë votuar majtas apo djathtas,si është kjo situatë?Konkretisht, ligjërisht sa ka qen parashiku kontrata në afat e ktyre punimeve për të cilën nuk jemi informuar, dimë që ka qenë kontrata deri në muajin Prill por sot jemi në Korrik.Ky është një shqetësim qytetar ku në çdo lagje të qytetit rrugët çahen, shkallmohen, qepen, mbulohet me asfalt njëra zonë ku është hapur kanal, rihapet përsëri asfalti, nuk mbulohet etj etj.Kto problematika,kohëzgjatja, modalitetet për të cilat do punohet me siguri kostot financiare që janë parashikuar,unë mbaj mend që na keni thënë që është një fond I gizit Gjerman, nuk kemi detaje të tjera.A jam më tepër I qartë seç isha në fillim?

Julian Doçi- Përfaqësues I Ndërmarrjes UKE

Përshëndetje,sot kam ardhur ti kthej përgjigje çdo pyetje të mundshme.Duhet marrë parasysh që është një investim madhor për qytetin e Elbasanit,por normalisht kemi sjellë dhe anomali si në trafik si në çrregullime në furnizim edhe në pjesën e ndotjes.Kërkoj ndjesë unë personalisht si qytetar I këtij qyteti.Përsa I përket pjesës tjetër ky si investim ka një grafik punimesh.Përfundimi ka qenë në muajin Qershor.Leja ndërtimit përfundon në muajin Dhjetor.Duke marrë parasysh mijëra kilometra tubacione dhe natyrën që kanë kto punime që kryhen nëpër rrugë, rrugica, brenda banesave, ka dhe vështirësi të veta.Kemi patur një shtyrje të vogël në afate po jo në kosto sepse kërkesa fillestare ka qenë sin ë kosto edhe në afat.Normalisht ne kemi miratuar, jo vetëm ne si shoqëri por edhe përfaqësuesit e supervizionit si dhe projektuesit duke qen se ka disa etapa dhe hapa për miratimin e çdo veprimi siç është:kërkesa fillestare,shqyrtimi nga supervizori,miratimi nga Banka Gjermane.E theksoj sërish është një punë madhore dhe një përfitim shumë I madh për qytetin që dhe këto 2-3 muajt e fundit do bëjmë si do bëjmë dhe do ta kalojmë.Ne përfitojmë cilësi shumë të mirë të ujit të pijshëm,ne e kemi super cilësinë po duke qenë se kemi patur një rrjet të vjetër dhe të amortizuar ,në investimin e ri minimalisht uji do jetë I pijshëm.Presion më të lartë në rrjet,orare

më të zgjatura deri në 24 orë. Nuk jam politik në pozicion tim të punës, nuk është premtim politik por është studim projektim, jemi në fazë zbatimi.

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Çfarë linjash keni bër, kam edhe unë disa pyetje sepse e shikoj që është shqetësim I të gjithëve, kam disa pyetje teknike që edhe tek mbledhjet e jona që kemi bër në bord nuk ka pas pjesë teknike. Çfarë linjash keni mbyll, pse nuk mbyllen linjat e lagjeve, pse I keni lënë të hapura kaq gjatë? E dyta çfarë është sistemi huazor, pse keni thënë disa herë në kërkesat tuaja sistemet huazore. Pse rihapen ato që mbyllen? Mбай mënd te kthesa te konvikti është hapur 4 herë, pse është hapur 4 herë dhe mban njeri përgjegjësi, supervizorët për këtë që pse është hapur ajo sepse dhe ne kemi bezdisje në qarkullim, kemi pengesa. Pse është hapur 4 herë tek parku Rinia te rruga e stadiumit? Qamil Guranjaku pse nuk është mbylluar akoma, rruga Rinia gjithashtu, teknikisht këto pse nuk mbyllen? Përherë shpreheni me çështje teknike, që teknikisht duhet të bëhet kolaudimi I mjetit, pse se bënë këtë kompania çfarë problematikash ka?

Julian Doçi- Përfaqësues I Ndërmarrjes UKE

Normalisht ka patur një grafik për asfaltimin dhe zbatimin e projektit. Në këtë rast ne dhe me kërkesën tonë dhe me kërkesën tuaj I kemi devijuar këto për përmirsim dhe kam lënë vetëm nyjet pjesët takuese dhe janë detyruar të hedhin vetëm një shtresë, të bëjnë të mundur trafikun dhe ta rihapim për interspektimet e linjave.

Ilir Mema-Inxhinier I kompanisë

Përshëndetje, unë jam inxhinieri I kompanisë që po kryen punimet e zbatimit dhe desha të shpjegoj nga ana teknike pyetjen pse është e nevojshme hapja e 2-3 herë e kësaj nyje. Në projektin tonë është parashikuar që rrjeti I ri ka disa pika kontakti me rrjetin ekzistues. Në disa rrotondo apo në disa pika që rihapen, ndodh që ne bëjmë sondazhe hapim dhe na ndodh që ka përplasje me rrjetet e telefonisë apo me rrjetet me tuba çelikë të vjetra dhe në këto momente që përplasjet infrastruktura ne duhet ta mbyllem, dhe bëjmë propozime çfarë zgjidhje teknike do I jepet duke kaluar nga poshtë apo nga sipër apo mënyra të tjera. Pastaj bëhet porosia e materialeve që vijnë nga Gjermania që vonojnë afër 1 muaj dhe kjo është një shkak pse hapet për herë të dytë. Ka shkaqe të tjera lidhja me ekzistuesin ne e bëjmë në periudhën e verës dhe është shumë e vështirë të ndërprehet furnizimi me ujë gjatë kohës që ne

bëjmë lidhje me ekzistuesët. Në moment që ne lidhim një nyje duhet që ujësjellësi ta ndërpresë furnizimin me ujë nga depot sepse saraçineskat e vjetra nuk arrijnë ta influencojnë këtë fragment që ne punojmë, kjo ka shkaktuar disa herë që edhe pas rifillimit të furnizimit rrjeti kërkon 3-4 ditë të stabilizohet dhe nga Ndërmarrja e Ujësjellsit na është vënë prioritet furnizimi me ujë dhe jo përfundimi i ktyre nyjeve. Konkretisht në lidhje me kto nyjet që folëm bëhet fjalë vetëm për lidhjet me ekzistuesin kur ne e hapim, gjejmë çfarë materialesh na kërkohen për të bërë lidhjen dhe pastaj mbasi vijnë materialet bëjmë lidhjet dhe bëjmë përfundimin e ktyre nyjeve. Kjo është arsyeja pse hapet 2 herë dhe nuk është se ka ndonjë arsye tjetër sepse nga ana e zbatimit, kontraktori shpenzime i ka ti hapi 2 herë dhe nuk ka as interes të ribëjë punë. Vështirësitë janë për gjendjen ekzistuese sepse mungojnë hartat, mungojnë informacioni i saktë se si është gjendja ekzistuese të tubacioneve apo rrjeteve dhe infrastrukturave të ndryshme që shumë herë dhe ne na vihet jeta në rrezik. Besoj se është e qartë pse nevojitet disa herë që të hapen 2 herë nyjet.

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Pse ju i keni patur, i keni patur të gjitha hartat dhe çfarë materialesh janë, dhe sa është tubi, dhe projektin e keni, e ka bërë po kompani Gjermane. Pse e ke këtë problem?

Ilir Mema-Inxhinier I kompanisë

Dalin tubacione ekzistuese të vjetra çeliku që nuk ka formacion për to

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Ujësjellësi e di çfarë tubash ka aty poshtë, i ka çeliku kur e ka bërë investimin, e nëse ka bërë investimin para 50 vjetësh çeliku do jetë, nëse është bërë investimi para 15 vjetësh do jetë material tjetër, e ka të qartë këtë pjesë

Ilir Mema-Inxhinier I kompanisë

Nuk dihet nga del, është psh në dalje të rotundos pastaj ne punojmë rotondon bëjmë lidhjen e ai na del na pengon të bëjmë lidhjen

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Çfarë tubash po vendosni?

Julian Doçi- Përfaqësues I Ndërmarrjes UKE

Tubacionet e vjetra të ishmetalurgjikut që kalojnë përmes qytetit janë të vjetra të viteve 1960-1964. Nuk është se ne kemi një informacion ekzakt siç kërkohet në zbatim të projektit sepse kur shkon për gjurmim e do plus minus 10 cm jo 2 metra siç e kemi ne pastaj nuk është vetëm ujësjellësi dhe kanalizimet, është elektriku, është telekomi, gjithë shoqëritë me rradhë që shfrytëzojnë nëntokën.

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Kam dhe unë disa paqartësi komunitare që ndihmojnë, çfarë tubash po vendosni, çfarë prodhimi I keni tubat? Çfarë cilësie, certifikimi?

Ilir Mema-Inxhinier I kompanisë

Janë të gjitha me origjinë Europiane dhe janë të certifikuara me Iso 9001 dhe disa certifikime të tjera për të miratuar për ujin e pijshëm. Kompania e supervizionit është Kompania Dalen, është kompania Gjermane që bën aprovimin e materialeve, specifikimet teknike janë si në Gjermani në bazë të euro normave kështu që çdo material kalon një filtër cilësie si në Europë. Materialet vijnë nga Gjermani prandaj dhe vonojnë. Tubacionet janë të diametrave nga 63-600 mm

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Po kto mbetjet që keni lën këtu, kur do I hiqni se ne po ju sjellim gjobë. Jua kemi thënë disa herë masat administrative, kur do I hiqni? Pse I keni kaq problem ti pastroni?

Ilir Mema-Inxhinier I kompanisë

Është një procedurë në vazhdimësi, punohet diku, pastrohet pastaj bëhet një gropë tjetër duhet të ripastrohet. Çdo ditë hapet një gropë, bëhet një lidhje matësi, gjenerohen mbeturina që të nesërmen duhet të pastrohen e kështu vazhdon diku pastrohet e diku bëhet prapë. Asfaltimet janë në proces Akoma. Disa raste kemi dhe asfaltime provizore për nyjet që rihapen dhe duhet që të mbarojnë në mënyrë përfundimtare e të pastrohen. Në disa zona është bërë lidhja përfundimtare, janë bërë të ndara me Dma që I quajmë ne. Disa zona janë future në punë. Jemi në fazën e montimit të matsave dhe të dezinfektimeve, shplarjeve dhe lidhjeve me rrjetin e

ri. Ajo që na vështirson këtë moment do presim të kalojmë periudhën e verës sepse lidhjet me ekzistuesin kërkojnë stakimin e depos. Stakimi në depo do krijojë shqetësime në furnizim kështu që është diçka komplekse e ndërlidhur. Presim me kalimin e temperaturave në Shtator presim që të menaxhojmë më mirë sepse bien pak kërkesat për ujë dhe rikuperimi gjatë mbylljes dhe hapjes së depove mund të rikthehet në normalitet më shpejt. Ne kemi kryer deri tani rreth 50 kilometra linjë kryesore dhe rreth 18 kilometra linja shtëpiash. Përqidja e punimeve në rrjet është 90%, kemi 3 km për të bërë nga 50 km që janë bërë. Pjesa e punimeve pastaj është kthimi në gjendjen e mëparshme, ky është fokus që kemi këtu 3-4 muaj dhe punimet në depo që po vazhdojnë kështu që lidhja me ekzistuesin nuk kanë mbetur shumë kanale vetëm 3 km nga 50 km

Zamir Muzhaqi-Nënkryetar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Duhet të kemi një tabllë më të qartë të këtyre problematikave. A do ta arrijmë datën e përfundimit të punimeve?

Ilir Mema-Inxhinier I kompanisë

Ne jemi në proces të asfaltimeve, të kthimeve në gjendje të mëparshme, të gjitha rrugët rrugicat I kemi detyrim kontraktual të kthejmë në gjendjen e mëparshme. Për këtë ka një garanci kontrata prej 10% që është vlerë e konsiderueshme që na detyron të kthejmë patjetër në gjendjen e mëparshme. Kemi detyrime kontraktuale që nuk I shmangeni, nuk është ky premtimi im që të kthejmë ne, me dëshirën time në gjendjen e mëparshme apo jo, janë detyrime kontraktuale që kanë penalitet përkatëse

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Edhe një pyetje se e kam për ujësjellësin, pse na janë ankuar shumë banorë që lagjia sipër tek Partizani nuk ka ujë në katet e sipërme? Tek Qamil Guranjaku e kishit mbyll atë problemin, tek Partizani pse ka problem?

Julian Doçi- Përfaqësues I Ndërmarrjes UKE

Sic e thash dhe më përpara ne kemi pas problem me furnizimin e ujit të pijshëm, duke marrë parasysh edhe temperaturat e larta dhe anomalitë që na erdhën nga takimi I rrjetit të ri me rrjetin ekzistues. Nga ajo periudhë deri në periudhën e

Shtatorit nuk besojmë që do bëjnë më takime në rrjetin ekzistues, mos kemi ndërpreje të furnizimit me ujë

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Ku po punoni tani?Sa po I zgjeroni depot?

Julian Doçi- Përfaqësues I Ndërmarrjes UKE

Momentalisht nuk po kryejmë punime në depot kryesore në periudhën e verës, që të fillojnë punimet mbas Shtatorit.Normalisht ka kohën e vet për zbatimin e ktyre punimeve siç ishte shëmbja e depove jashtë funksionit dhe ndërtimi I depos 2000 m3.Momentalisht po punojmë me gjysmën e kapacitetit të depos së re, shumë shpejt do vendosim edhe 1000 m3 që do jenë në furnizimin kryesor të qytetit.Jemi drejt përfundimit në depon e Krastës se Vogël dhe në përfundim në depot e Krastës së Madhe.Pas shtatorit do kalojmë në rikonstruksione e dy depove të tjera të qytetit që nuk do ndikojnë në pjesën e furnizimit përsa kohë do vendosim depon e re 2000 m3.Përsa I përket kapacitetit grumbullues, ti kthej dhe përgjigje zotërisë nga eksperiencia që unë kam, ne kemi kapacitet grumbullues në depo dhe I vetmi problem që kemi konstatuar ka qen te pjesa shpërndarjes, te rrjeti I amortizuar dhe te lidhjet e paligjshme.Duke futur në funksion 80% të qytetit me rrjet të ri automatikisht ndarë në zona matje siç e tha dhe inxhinieri ne do konstatojmë në kohë reale humbjet që do kemi në secilën lagje, në secilën zonë.Do të jetë monitorimi shume më I mirë seç e kemi patur

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Çfarë po bëni për lidhjet e paligjshme?Çfarë garancie kemi ne të gjithë si qytet që spo bëhen lidhje të paligjshme siçka pas qen tradicionalisht që thonin po bëhet linja e re hajde ta fusim..siç kemi patur zonën e Krastës tradicionalisht kanë ndërhyr tek tubat derisa u vu linja e re.Sot çfarë garancie kemi ne që edhe tek ky rrjet I ri nuk ka lidhje të paligjshme?

Julian Doçi- Përfaqësues I Ndërmarrjes UKE

Përsa I përket çdo nyje është me elektrofuzion, nuk është me Bashkim mekanik siç ka qen më përpara.Materiali duke qen se porositet nga jashtë nuk është I disponueshëm në magazine ose në shitje pra është shumë I vështirë ta gjesh.Ka edhe teknologji të atillë, mënyra e instalimit.Para vënies në punë janë edhe testimet

përkatëse, secila linjë karikohet, mbahet në presion deri në moment që të sigurohet që ska asnjë lloj rrjedhje dhe asnjë humbje në rrjet. Vëzhgimi si nga ana e supervizionit si nga ana e shoqërisë janë ngritur grupe përkatëse që verifikojnë çdo ndekje deri në momentin e asfaltimit të ktyre rrugëve që mos kryhen linja të paligjshme në rrjet e ri. Një rast që u kap nga matja e presionit, është kallzuar në polici dhe është bërë mediatik si shembull që mos ndërhyet më në rrjet. Do jet shumë më e lehtë në ditët në vazhdim, në momentin që do vendosim rrjetin e ri do jet shumë e lehtë evidentimi i çdo anomalie që do ketë në zonë. Gjithashtu ne kemi marrë dhe një paisje dedektore që do na shërbejë në të ardhmen për përmirsimin e cilësisë dhe shërbimit

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Faleminderit kryetar, faleminderit të gjithëve. Besoj që në muajin Gusht nëqoftëse nuk do kemi tema shumë për të diskutuar mund ta bëjmë qarkulluese Ditën e mirë!

Mbledhja përfundon në orën 15:56

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar i Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani

